Tirane, me 15 / 09 /2016

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISE AKSIONARE

" ADTN" SH.A

Ne mbeshtetje dhe zbatim te dispozitave te ligjit Nr. 9901, date 14.14.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, themelohet shoqeria aksionare e emertuar **"ADTN" SH.A** (me poshte ne kete akt e quajtur "Shoqeria").

Aksionari i pare themelues eshte si vijon:

Shoqërisë **"DIGIT-ALB" sh.a,** me adresë: Mëzez, Kashar Tiranë, me numër NIPT- it: **K 41719004 D**, e rregjistruar si person juridik me vendimin Nr: 31333 dt.29/03/2004 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në Tiranë, e përfaqësuar nga Administrator i Përgjithshëm **z. Alban JAHO**, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe në emër të shoqërisë, më poshtë referuar si **"Digitalb"**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen **3.500.000 (tremilion e peseqindmije) leke.**
Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuota.

Objekti i veprimtarise do te jete:
Ndertim,tregetim, te sistemeve dhe rrjeteve te telekomunikacioneve. Prodhim te sherbimeve audio dhe video. Ndertimi dhe tregtimi i sistemeve te telekornunikacionit dhe transmetimeve televizive. Tregtimi i aparaturave per sistemet e transmetimit dhe marrjes se valeve televizive. Prodhimi transmetimi dhe shitja ne menyre dixhitale e produkteve dhe sherbimeve audio e video. Prodhim filma artistike qe cdo lloji dhe cdo metrazhi, organizim i aktiviteteve kinematografike, artistike dhe audiovizuale te cdo lloji, dokumentare, show televiziv, emisione, spektakle, videoklipe dhe cdo lloj forme tjeter prodhimi audio apo audiovizive te njohur apo qe do te ekzistoje ne te ardhmen, si dhe distribucioni dhe shperndarja e tyre ne cdo forme ne Shqiperi dhe jashte saj. Transmetim televiziv si platformen numerike me dhe pagese.

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per nje periudhe kohe te pacaktuar. Kjo periudhe mund te ndryshoje paraprakisht me vendim te Asamblese se Pergjithshme ose per shkaqe te tjera te parashikuara nga ligji.

Selia administrative e shoqerise do te jete ne Shqiperi, Tirane, Kashar, Rruga "Pavaresia", Nr.39,

Administrimi: Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i vetem, detyren e te cilit do ta kryeje per periudhen e pare prej 1 (nje) viti **Z.Andi CENKO** i cili do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblese se Pergjithshme dhe per çeshtje te rendesishme konsultohet apo merr miratim sipas rastit nga Aksionari/et.

AKSIONARI THEMELUES:

SHOQERIA "DIGIT-ALB" SH.A
Perfaqesuar nga:
Alban JAHO[1]

Administrator i Pergjithshem

DIGITALB
info@digitalb.tv, www.digi...o.al

[1] Ky akt themelimi firmoset sipas vendimit nr. 6 date 12/09/2016 te AP te Aksionarit.